

Në fillim të 2014-ës, Ramush Haradinaj ende nuk ishte rehabilituar nga humbjet dërmuese të zgjedhjeve lokale, që e panë partinë e tij të humbasë Pejën, Gjakovën, Suharekën dhe Rahovecin. Haradinaj mbledhi strukturat e partisë dhe tha që duhet punuar shumë për vitin e zgjedhjeve qendrore.

Diskursi i tij dhe i njerëzve të partisë së tij kishte të bëjë gjithë kohën me qeverisjen e keqe të Thaçit dhe nevojën për ndryshimin e drejtimit edhe nga modeli që nuk duhej bartur i qeverisjes në Prishtinë nga Mustafa.

Drejtimit i Ri e quajti Haradinaj ofertën e tij zgjedhore që përfshinte edhe pagë mesatare prej 1000 eurosh dhe hapje të vendeve të punës për 200.000 veta. Të gjitha këto i tregoi në një reklamë të kopjuar tërësisht nga Presidenti Obama.

Takimet i transmetoi të gjitha direkt dhe ato ishin gjithashtu të stilit amerikan të town-halleve.

Të tillat arritën të bindin vetëm dikë mbi 9 % të kosovarëve. As në zgjedhjet e pesta pas luftës AAK-ja nuk fitoi përqindje dy-shifrore. Shija e idhët e humbjes edhe në AAK zgjati vetëm 2 ditë, pasi që rrugët e Prishtinës u mbushën me njerëz që festonin marrjen e lajmit – Ramush Haradinaj do të bëhej më në fund kryeministër i vendit. Haradinaj u bë zëri i Bllokut që do të udhëhiqte procesin e rrëzimit të Thaçit dhe PDK-së nga pushteti.

Ai shërbeu edhe për afrimin e VV-së në kuadër të bllokut të madh. Mbrojti gjithë kohën edhe partitë e tjera kur u duhej të shpjegonin bashkimin. Tha se i besonte Mustafës. Për më shumë se 5 muaj i përballoi bashkë me të sfidat e përpjekjeve për krijimin e institucioneve të reja që shkonin në kundërshtim me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por, kur i thanë se është mirë të spostohej sepse Mustafa duhej të bëhej kryeministër – Haradinaj nuk u zmbraps.

Kemi marrëveshje, tha dhe ajo duhet të respektohet. Vetëm ai mund të bëhej kryetar i qeverisë. Kur Mustafa e la për Thaçin tha se kjo ishte një tradhti e qartë.

As me VV-në nuk u nda mirë që e akuzoi për flirtim me Thaçin. Së paku teorikisht, Haradinaj kurrë nuk ishte më afër ta realizonte kthimin e tij të madh në postin e të parit të qeverisë.

Por, në vend të kësaj ai do të mbetet deputet i thjeshtë opozitar si pjesë e një grupi parlamentar të dobësuar rrënjësisht si rezultat i dështimit për t'u bërë deputet të Ardian Gjinit e Burim Ramdanit. /koha/